



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT KUKES**

**SHPALLJE PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PËR PRANIMIN NE
SHËRBIMIN CIVIL**

Në zbatim të nenit 22 dhe 25 të ligjit 152/2013, “Për Nëpunësin Civil” (*i ndryshuar*), si dhe të Kreut II, IV dhe VII të VKM Nr.243, datë 18.03.2015 “Per pranimin , levizjen paralele, periudhen e proves dhe emerimin ne kategorine ekzekutive” (I ndryshuar), Keshilli I Qarkut Kukës shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

1(nje) Specialist pranë Drejtorisë Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

Lloji i diplomës “Gjeodet”, niveli minimal i diplomës “Bachelor”

(Kategoria e Pages IV-3)

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është vend vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës pranimit ne shërbimin civil

Për të dy procedurat (*lëvizje paralele dhe pranim ne shërbim civil*) aplikohet në të njëjtën kohë !

Afati për dorëzimin e dokumentave për - **LEVIZJE PARALELE:** **18 Qershor 2026**

Afati për dorëzimin e dokumentave për - **PRANIMIN NE SHERBIMIN CIVIL:** **23 Qershor 2026**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin e punës:

Specialisti I DAMT ka per detyre:

- Mbajtjen, inventarizimin, administrimin dhe arkivimin e dokumenteve të arkivit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës
- Mban kontakte me organe te Qeverisjes Vendore: si ASHK dhe te tjera, per çështje që kanë të bëjnë me informacionet për ndryshimet e pronësisë dhe bashkimet e parcelave.
- Plotëson detyrat e përcaktuara mbi evidentimin e të dhënave për tokën bujqësore dhe të dhënat kadastrale.
- Mbajtjen, inventarizimin, administrimin dhe arkivimin e të gjithë akteve që përcaktojnë dëmtimet e tokës bujqësore
- Sistemimin, ruajtjen, arkivimin si dhe skanimin e të dhenave dhe dokumentacionit kadastral.

- f. Përditësimin e të dhenave të arkivit elektronik të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të rrethit Kukës.
- g. Arkivimin e vendimeve të organeve shtetërore përgjegjëse për kalimet dhe ndryshimet në gjendjen e tokave dhe bën pasqyrimet përkatëse për Bashkinë Kukës.
- h. Përmbush detyrat që përcaktohen nga aktet ligjore në fuqi, si dhe ato që ngarkohen nga Eprori direkt, Drejtori dhe Titullari i Institucionit.

1. LEVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda te njejtës kategori,
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor”.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrimin e aplikantit.
- b. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Vetë-deklarim të gjendjes gjyqësore.
- g. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Dokumentat duhet të dorëzohen prane Këshillit të Qarkut Kukës brenda dates **19 Qershor 2026**.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Në datën **23 Qershor 2026**, Njesia e Burimeve Njerezore në Keshillin e Qarkut Kukës, do të shpallë në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në faqen e zyrtare te internetit të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën date kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen nga Njesia e Burimeve Njerëzore, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

- a. Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për veteqeverisjes vendore”.
- b. Ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil”.
- c. Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”.
- d. Ligjin Nr.119/2014 te miratuar me date 18.09.2014 “Per te drejten e informimit”
- e. Ligjin Nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- f. Ligjin Nr.8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, të ndryshuar.
- g. Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”
- h. Ligjin Nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.
- i. VKM Nr. 121, datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë testimit dhe intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre përkarrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e Burimeve Njerëzore në Keshillin e Qarkut Kukës do të shpallë fituesin në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe në stenden e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. PRANIMI NE SHERBIMIN CIVIL

Vetem në rast se pozicioni i cituar me sipër, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, vazhdon procedura e konkurimit në shërbimin civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të internetit të Keshillit të Qarkut Kukës dhe në stendin e informimit të publikut duke filluar nga data **23 Qershor 2026**

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATET:

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatet janë:

- a. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar për kategorinë që konkuron.
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- c. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë Mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- b. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor”

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

- a) Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat për konkurim, të listuara në piken 1.2.
- b) Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo dorazi në Njesinë e Burimeve Njerëzore në Keshillin e Qarkut Kukës brenda datës **24 Qershor 2026**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Në datën **29 Qershor 2026**, Njesia e Burimeve Njerëzore në Keshillin e Qarkut Kukës do të shpallë në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, në faqen zyrtare të internetit të Keshillit të Qarkut Kukës, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e konkurimit në Shërbimin Civil si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos-kualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA:

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- c. Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për veteqeverisjes vendore”.
- d. Ligjin Nr.152/2013, “Për Nëpunësin Civil”.
- e. Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”.
- f. Ligjin Nr.119/2014 te miratuar me date 18.09.2014 “Per te drejten e informimit”
- g. Ligjin Nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- h. Ligjin Nr.8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, të ndryshuar.
- i. Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”
- j. Ligjin Nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.
- k. VKM Nr. 121, datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki”

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b) Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c) Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve do të njoftojë kandidatet në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Njësia e Burimeve Njerezore do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe në stenden e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për proçedurën e konkurimit në shërbimin civil, do të marrin informacion në faqen e internetit të institucionit, për fazat e mëtejshme të kësaj proçedure duke filluar nga data **29 Qershor 2026**